



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

RELACION

MBI MIRATIMIN SI PRIORITET TË INVESTIMIT PËR PROJEKTIN “NDËRTIM UJËSJELLËSI NË FSHATRA Velabisht, Starovë, Remanicë, Veterik - NJËSIA ADMINISTRATIVE Velabisht, BASHKIA BERAT”

Të nderuar këshilltarë!

Bashkia Berat një ndër prioritetet ka edhe furnizimin me ujë të pijshëm për banorët të saj. Në zonat të cilat janë më problematike janë edhe fshatrat Velabisht, Starovë, Remanicë dhe Veterik, që i përkasin Njësisë Administrative Velabisht.

Me rikonstruksionin e plotë të rrjetit të ujësjellësit në qytetin e Beratit, i cila ka filluar punë, krijohet mundësia që një sasi uji nga rrjeti i qytetit të përdoret për furnizimin me ujë të pijshëm të fshatrave të mësipërm.

Bashkia Berat zoteron 65.32% te aksioneve të Shoqërisë Aksionere Ujesjëlles Kanalizim,e Berat Kucovë .

Në këto fshatra mungon rrjeti i furnizimit me ujë dhe banorët furnizohen nga puse me ujë të pakontrolluara.

Për këtë arsye, Drejtoria e Planifikimit të Territorit në bashkëpunim me subjekte privat të licensuara, ka hartuar projekt-preventivin për objektin: "Ndërtim ujësjellësi në fshatrat Velabisht, Starovë, Remanicë, Veterik - Njësia administrative Velabisht, Bashkia Berat", me vlerë 158073494.65 lekë. Linja e furnizimit me ujë do të funksionojë me rrjedhje të lirë. Tubacioni i ujit do të shkojë në çdo banesë, ku do vendosen dhe matësat e ujit. Bashkë me ndërtimin e rrjetit të furnizimit me ujë projekti përmban dhe rrjetin e hidranteve në pikat ku ka më shumë grumbullim shtëpish.

Për financimin e këtij projekti është kërkuar financim Agjencisë Kombëtare Ujësajllës Kanalizime dhe Mbetjeve të Ngurta (AKUM).

Për rritjen e performances të shoqërisë në lidhje me furnizimin me ujë edhe në sektorin fshat, është e nevojshme ndërtimi i rrjeteve të ujësjellësive edhe në këtë sektor.

Për sa më sipër, propozojmë:

Të miratohet si prioritet, investimi **me vlerë 158 073 494.65 lekë**, sipas projekt-preventivit për objektin "Ndërtim ujësjellësi në fshatrat Velabisht, Starovë, Remanicë, Veterik - Njësia administrative Velabisht, Bashkia Berat."

Faleminderit .

DREJTORI
Ing. Sllavi DHRAMI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA BERAT

PROJEKTVENDIM

MBI MIRATIMIN SI PRIORITET TË INVESTIMIT PËR PROJEKTIN “NDËRTIM UJËSJELLËSI NË FSHATRAT VELABISHT, STAROVË, REMANICË, VETERIK - NJËSIA ADMINISTRATIVE VELABISHT, BASHKIA BERAT”

Kryetari i Bashkisë pasi u njoh me materialin e paraqitur nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, mbështetur në ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 7, pika 2, neni 8, neni 9 pika 1.1, gërma “a”, neni 54, 64 gërma “c”,

PROPOZON :

1. Të miratohet si prioritet, investimi **me vlerë 158 073 494.65 lekë**, sipas projekt - preventivit për objektin "Ndërtim ujësjellësi në fshatrat Velabisht, Starovë, Remanicë, Veterik - Njësia administrative Velabisht, Bashkia Berat."
2. Financimi i objektit do të kryehet me fondet e buxhetit të shtetit.
3. Me ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

KRYETARI I BASHKISË

Ervin DEMO



Projektvendimi u pa dhe ka bazueshmëri ligjore.

JURISTE
Nertila Kadëna

SEKRETARE E KESHILLIT BASHKIAK
Bora Agalliu